



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



10 /Nr. 9949 /2022
Data: 05.12.2022

PROCESVERBAL I DEBATI PUBLIK

Mbajtur me datë 22.11.2022 në Sallën e Takimeve të Komunës së Hanit të Elezit. Ashtu siç ishte paralajmëruar nëpërmes informimit debati publik filloi në ora 15:00. Prezent ishin 15 qytetarë të Komunës së Hanit të Elezit. Në debat publik prezent ishte edhe Nënkryetari i Komunës z. Sevdi Dernjani.

Takimin e kryesoj Drejtori për Shërbime Publike dhe Emergjencë z. Arsim Dernjani.

Rendi i Punës

1. Plotësim ndryshimi i rregullore për Transportin Rrugorë në Territorin e Komunës së Hanit të Elezit.

Sevdi Dernjani ju falënderoj të gjithëve për prezencën dhe ju e dini që është procedurë ligjore që me organizuar edhe debatin publik nëse ndonjë rregullore propozohet për plotësim ndryshim në kuvend. Drejtori për shërbime publike dhe emergjencë do t'i prezanton plotësim ndryshimet të cilat i ka dërguar për në kuvend.

Arsim Dernjani kërkesë kemi pasur nga personat të cilët punojnë si auto taksi për me i propozuar Kuvendit për me bërë plotësim ndryshim e kësaj rregullore. Fillimisht e kemi dërguar për shqyrtim në Komitet për Politik e Financa pastaj në Kuvend dhe Kuvendi e ka votuar për në debat publik. Andaj propozimet i keni para vetës dhe nëse keni edhe ndonjë propozim apo sugjerim mund të parashtroni dhe ja përcjellim Kuvendit.

Amir Bushi është mirë që veturat me pasur shenja nëse bartin personin me aftësi të kufizuara.

Arsim Dernjani a keni edhe ndonjë propozim për Plotësim ndryshimi e rregullore për Transportin Rrugorë në Territorin e Komunës së Hanit të Elezit. Nëse nuk keni propozimet e parashtruara do t'i përcjellim për në kuvend për shqyrtim dhe ata të cilët i vlerëson kuvendi që janë të arsyeshme besoj se do të miratohen.

Debati përfundoi në ora 15:25 .

Procesmbajtësi

Amir Bushi

Drejtori për Shërbime Publike dhe Emergjencë

Arsim Dernjani

